



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER BELINDA V. ÇELAJ
ADRESA NR.5, ISMAIL QEMALI,
NR.3/118
TEL: 0692077776

MARRËVESHJE SIGURUESE

(MARRËVESHJE KOLATERALI FINANCIAR)

Nr. repertori: 3187

Nr. koleksioni: 1140

Tirane më 19/09/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07 1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, datë 10/03 2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12 2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2022050310122986986

REPUE
BEL
NO
TIR

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA KOMBETARE E NOTEREVE
ZYRA VENDORE Tirane
NR. 3137 REP.
NR. 1140 KOL.

MARREVESHJE KOLATERALI FINANCIAR

Sot, me 19/09/2022, ne Tirane, perpara meje noter Belinda Selaj, u paraqiten personalisht palet e meposhtme, te cilet deklarojne perpara meje se me vullnetin e tyre te lire lidhin kete marreveshje kolaterali financiar si me poshte:

KOLATERALMARRES: Banka e Pare e Investimeve – Albania ShA, regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me vendim nr. 35506, date 19.04.2006 te Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane, NIPT K72014801J, me seli ne adresen Bulevardi “Deshmoret e Kombit”, Kullat Binjake, Kulla 2, kati 14, Tirane, e perfaqesuar rregullisht nga znj. Elma Lloja, shtetase Shqiptare, ne cilesine e Drejtores Ekzekutive dhe znj. Ina Paskaleva, shtetase Bullgare, ne cilesine e Drejtores se Departamentit te Menaxhimit te Riskut, te dyja madhore, te dyja madhore, me zotesi te plote dhe per te vepruar, e quajtur ne vijim **Kolateralmarres**,

dhe,

KOLATERALDHENES:

Shoqeria SA-GLE KOMPANI SHPK, regjistruar ne Regjistrin Tregtar te mbajtur nga Qendra Kombetare e Biznesit me Numer Unik te Identifikimit (NIPT) K92227019N, me seli ne Fier, Lagja Sheq i Madh, Rruga nacionale Fier - Tiranë, Pranë Urës së Mbrostarit, perfaqesuar nga znj. Anilda Besim Goga, shtetase Shqiptare, lindur me date 18.11.1981, ne Fier, mbajtesi i leternjoftimit me nr. 034523775, me numer personal I16118041M, leshuar me date 31.07.2019 nga M.B, banues ne: Fier, Rr. Blv. Jakov Xoxa, Lagja Kongresi i Permetit, madhore, me zotesi te plote per te vepruar, ne cilesine e administratorit te shoqerise, i autorizuar me Vendimin e Ortakut te Vetem nr. 3133 Rep., date 19. 09. 2022, i quajtur ne vijim **Kolateraldhenes**.

Shoqeria AG Hpower & Construction SHPK, regjistruar ne Regjistrin Tregtar te mbajtur nga Qendra Kombetare e Biznesit me Numer Unik te Identifikimit (NIPT) L91924026B, me seli ne Fier, Lagja Sheq i Madh, Rruga nacionale Fier - Tirane, Prane Ures se Mbrostarit, Fier, perfaqesuar nga z. Zeni Nebi Tërpollari, shtetase Shqiptare, lindur me date 13.08.1984, ne Çorovodë, mbajtesi i leternjoftimit me nr. 035364689, me numer personal I40813012F, leshuar me date 18.12.2019 nga M.B, banues ne: Tirane, Rr. Eduart Mano, pallati Best Construction, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, ne cilesine e administratorit te shoqerise, i autorizuar me Vendimin e Ortakut te Vetem nr. 5184 Rep., date 19. 09. 2022, i quajtur ne vijim **Kolateraldhenes**.


PRANUESI I KOLATERALIT:

Arben Pandi Goga, shtetas Shqiptar, lindur ne Fier me date. 23.11.1968, mbajtes i leternjoftimit me Nr. 034871169 me Nr. personal G81123041J, leshuar me date 07.10.2019 banues ne: Fier, Rr. Blv. Jakov Xoxa, Lagja Kongresi i Permetit, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, i quajtur ne vijim **Pranuesi**.

Te cilat se bashku do te referohen ne kete marreveshje si “Palet”

Duke qene se palet e mesiperme kane lidhur nje Kontrate Kredie Bankare, me date 19/09/2022, me Nr. 3135 Rep. dhe Nr. 1138 Kol., Nr. Ref. 000KR-AA-1941 sipas se ciles Banka i jep Kredimarrësit shoqerise SA-GLE KOMPANI SHPK, regjistruar ne Regjistrin Tregtar te mbajtur nga Qendra Kombetare e Biznesit me Numer Unik te Identifikimit (NIPT) K92227019N dhe dorezanesve shoqerise AG Hpower & Construction SHPK, regjistruar ne Regjistrin Tregtar te mbajtur nga Qendra Kombetare e Biznesit me Numer Unik te Identifikimit (NIPT) L91924026B dhe Arben Pandi Goga, nje shume prej Leke 112,000,000 (njeqind e dymbjedhete milion leke), palet





lidhin kete Marreveshje Kolaterali Financiar per garantimin e detyrimeve qe rrjedhin nga kjo Kontrate e Kredise Bankare dhe cdo shtese apo amendim apo aneks i saj, (e cila me poshte do te referohet si "Kontrata"), sipas kushteve te meposhtme:

1. Përkufizime

- 1.1 Kolaterali financiar eshte nje garanci, e cila vendoset nga Kolateraldhënësi ne posedim te Kolateralmarresit per te garantuar detyrimet financiare te Kolateraldhënësit ndaj Kolateralmarresit, perfshire ato te tanishmet ose te ardhmet, ato aktuale ose te kushtezuara apo te mundshme.
- 1.2 Llogaria e kolateralit eshte nje llogari e vecante ne te cilen derdhet ose transferohet kolaterali financiar, dhe nga e cila behen te gjitha veprimet me kolateralin sipas kushteve te kesaj marreveshje dhe Kontrates e Kredise Bankare.
- 1.3 Termat të cilat nuk janë përkufizuar në këtë Kontratë por janë përcaktuar në Kontratën e Kredise Bankare do të kenë të njëjtin kuptim që u është dhënë në Kontratën e Kredise Bankare, apo ne shtesat e amendimet e saj te mundshme.

2. Objekti i Marreveshjes/Kolaterali Financiar

- 2.1 Palet bien dakort qe detyrimet financiare qe rrjedhin nga Kontrata e Kredise Bankare, shtesat, anekset apo amendimet e saj te garantohen nga kjo Marreveshje per Kolateral Financiar.
- 2.2 Kolateraldhënësi merr persiper te vendose në favor të Kolateralmarresit,
 - a) **100% (njeqind perqind) te kuotave te shoqerise SA-GLE KOMPANI SHPK, regjistruar ne Regjistrin Tregtar te mbajtur nga Qendra Kombetare e Biznesit me Numer Unik te Identifikimit (NIPT) K92227019N, te pasqyruara prej shoqerise ne zerat e bilancit financiar dhe te specifikuara sipas ekstraktit te QKB-se bashkengjitur kesaj marreveshje.**

si kolateral financiar, e cila do te referohet me poshte si "kolaterali financiar" për të garantuar ripagimin e kredisë sipas kushteve te percaktuara ne Kontrate.

Kjo prone e luajtshme do te sherbeje si kolateral financiar, garanci duke u vendosur ne radhe te pare ne favor te Bankes se Pare te Investimeve – Albania ShA, deri ne shlyerjen e plote te detyrimit ne total me vlere Leke 112,000,000 (njeqind e dymbedhete milion leke), detyrim ky qe rrjedh nga Kontrata e Kredise Bankare (e quajtur ne vijim Kontrata e Kredise), qe do te lidhet me kredimarresin SA-GLE KOMPANI SHPK, regjistruar ne Regjistrin Tregtar te mbajtur nga Qendra Kombetare e Biznesit me NIPT K92227019N.

Une i nenshkruari, z. Arben Pandi Goga ne cilesine individuale te pranuesit te kolateralit te kesaj marreveshje, deklaroj se jam dakort te vendoset barre mbi pronen e pershkruar me siper ne favorin e Bankes te Pare te Investimeve – Albania ShA dhe se heqim dore nga çdo pretendim mbi pronen dhe te drejtat mbi te pergjate gjithë kohezgjatjes se detyrimit ndaj Barremarresit / Kolateralmarresit.

- 2.2 Çdo referim ne lidhje me Kolateralin do te nenkuptoje Kolateralin apo nje pjese te tij.
- 2.3 Kolateralmarresi pranon te marr ne posedim dhe te kete kontroll mbi kolateralin financiar.
- 2.4 Kolaterali financiar, shuma e percaktuar si me siper nuk mund te barresohet apo te perdoret ne marreveshje te tjera nga kolateraldhënësi si mjet garancie per detyrime te tjera te tij persa kohe eshte ne fuqi kjo marreveshje apo deri ne shlyerjen e detyrimeve te Kontrates se Kredise Bankare.



3. Posedimi i Kolateralit Financiar

3.1 Kolateralndhënesi i kalon ne posedim kolateralin financiar Kolateralmarresit nepermjet dorezimit faktik, regjistrimit ose duke e transferuar shumen e siperpermendur tek Kolateralmarresi.

3.2 Kolateralmarresi gezon mbi kolateralin financiar te drejten e posedimit si dhe cdo te drejte qe I njihet poseduesit ne baze te Kodit Civil te R.SH perفشire ketu cdo interes te mundshem te perfituar.

4. Detyrimet e Kolateralndhënësit

4.1 Kolateralndhënësi njih si posedues te kolateralit financiar Kolateralmarresin dhe garanton se heq dore nga e drejta per te kryer veprime ne llogarine e kolateralit financiar, e cila kontrollohet dhe administrohet nga kolateralmarresi deri ne momentin e shlyerjes se plote te kredise ne baze te Kontrates se Kredise ne perputhje me afatet dhe kushtet e parashikuara ne te.

4.2 Kolateralndhënesi njih te drejten e Kolateralmarresit te perdore kolateralin financiar per te permbushur cdo lloj detyrimi te plote ose te pjesshem qe lind nga Kontrata e Kredise Bankare. Kjo e drejte eshte e parevokueshme deri ne momentin e shlyerjes se plote te te gjitha shumave te papaguara te Kolateralndhënesit.

4.3 Kolateralndhënesi garanton dhe njih se cdo kalim pronesie I mundshem mbi kolateralin (dhurim, trashegimni, zgjidhje martesë etj) nuk do te preke te drejtat e Kolateralmarresit mbi kolateralin financiar te percaktuara ne kete marreveshje.

5. Ekzekutimi i Kolateralit Financiar

5.1 Kolaterali financiar I nenshtrohet ekzekutimit te menjehershëm pa pasur nevojë per te ndjekur proceduren per ekzekutim vullnetar apo te detyrueshem nepermjet gjykates dhe permbaruesve sic percaktohet per mjetet e tjera te garancise ne legjislacionin shqiptar.

5.2 Kolateralmarres ka te drejte te ekzekutoje menjehere nga llogaria e kolateralit financiar shumen e plote apo te pjesshme te detyrimit qe rezulton I papaguar sipas Kontrates se Kredise Bankare pa pasur nevojë per te njoftuar paraprakisht Kolateralndhënesin. Me konkretisht kolateralmarrësi ka te drejte te mbaje nga llogaria e kolateralit financiar shumat e renditura si me poshte:

5.2.1 Ne fillim do të ekzekutohen /mbahen interesat, penalitetet si dhe shpenzim tjetër I mundshëm;

5.2.2 Me pas do te ekzekutohen/mbahet, shumat e pashlyer e principalit të kredise.

5.3 Cdo shume e ekzekutuar nga llogaria e kolateralit financiar do te konsiderohet si shlyerje per llogari te detyrimeve te Kontrates se Kredise dhe/ose shtesave, anekseve apo amendimeve te saj.

5.4 Kolateralmarresi do te njoftoje Kolateralndhënesin debitor per cdo transferim shumash te kryera nga llogaria e kolateralit duke I bere te ditur pretendimin e tij mbi kolateralin ne baze te Kontrates se Kredise, shtesave apo amendimeve te saj dhe kesaj Marreveshje.

5.5 Kolaterali financiar nuk I nenshtrohet ekzekutimit te kerkuar per shkak te mospermbushjeve te detyrimeve te tjera te Kolateralndhënesit, nese Kolateralmarresi nuk ka dhene pelqim paraprak. Me konkretisht kolaterali financiar do te konsiderohet I vecuar dhe I pækzekutuëshëm pavaresisht:

5.5.1 Hapjes se procedures per paaftesi pagueese te kolateralndhënesit apo kolateralmarresit

5.5.2 Ndonje mase sigurimi, sekuestroje ose urdheri apo vendimi te ngjashëm gjyqësor, permbarimor apo cdo organi tjetër ne lidhje me te drejatat dhe detyrimet e kolateralndhënesit.

6. **Kohezgjatja e Marreveshjes se Kolateralit Financiar dhe veprimet e mbylljes**

6.1 Kjo marreveshje per kolateral financiar eshte e vlefshme deri ne shlyerjen e plote te detyrimeve te Kontrates se Kredise Bankare dhe cdo shtese, aneksi apo amendimi te saj.

6.2 Kolaterali financiar sipas kesaj marreveshje mbetet ne posedimin e Kolateralmarresit deri ne shlyerjen e plote te detyrimeve te Kontrates se Kredise dhe cdo shtese, aneksi apo amendimi te saj.

6.3 Kolateralmarresi do te quaje te perfunduar kete marreveshje kolaterali financiar me pagesën e plote të detyrimeve te Kontrates se Kredise dhe cdo shtese, aneksi apo amendimi te saj. Pas shlyerjes se plote te detyrimeve te sipercituara, Kolateralmarresi do t'i vendose ne posedim Kolataraldhenesit shumen perkatese te vendosur si kolateral financiar:

6.3.1 duke ia transferuar shumen ne nje llogari tjetere te kolataraldhenesit;

ose

6.3. duke I dhene kolataraldhenesit akses te plote per veprime ne llogarine e kolateralit, e cila pushon se qeni si e tille pas shlyerjes se plote te detyrimeve te sipercituara.

6.4 Ne rast se Kolateralmarresi ka bere ekzekutimi te pjeshme ne llogarine e kolateralit sis eshte parashikuar ne kete marveshje, atehere kolateralmarresi do t'i ktheje ne perfundim te shlyerjes se te gjitha detyrimeve te Kontrates se kredise dhe cdo shtese apo amendimi te saj Kolataraldhenesit ne posedim, shumen perkatese e cila rezulton si balance kreditore e mbetur ne llogarine e kolateralit financiar.

7. **Ligji I zbatueshem/Interpretimi I Marreveshjes**

7.1 Kjo Marreveshje per Kolateral Financiar eshte e lidhur dhe do te konsiderohet per efekt interpretimi dhe ekzekutimi si pjesë përbërëse e Kontratës së Kredisë Bankare.

7.2 Kjo Marreveshje I nenshtrohet legjislacionit shqiptar ne pergjithesi dhe rregullimit te posacem te parashikuar ne Ligjin "Per sistemin e pagesave" Nr. 133/2013, date 29.04.2013.

7.3 Cdo kusht apo formulim qe mund te sjelle paqartesi do te interpretohet ne kontekstin e teresisë se Marreveshjes dhe Kontratës se Huase, si dhe stesave apo amendimeve te saj dhe ne kendveshtrimin e qellimit qe i shtyu palët te lidhin këtë Kontratë.

8. **Zgjidhja e mosmarrveshjeve**

8.1 Palëve do te mundohen te zgjidhin mosmarrveshjet e tyre me mirekuptim ne te kundert kompetente per zgjidhjen e mosmarrveshjeve eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane

9. **Gjuha e Kontrates**

9.1 Kjo kontrate eshte e hartuar ne gjuhen shqipe ne 3 (tre) kopje origjinale.

10. **Ndryshimet dhe shtesat ne Kontrate**

10.1 Cdo ndryshim apo shtese ne kete Kontrate do te jete i vlefshem ne rast se hartohet me shkrim dhe nenshkruhet nga te dy palët.

11. **Njoftimet**


11.1 Te gjitha njoftimet ndermjet paleve do te behen me shkrim ne menyren qe eshte parashikuar ne kete e marreveshje. Njoftimet, apo komunikimet do te behen ne adresat e meposhtme, te cilat do te konsiderohen te vlefshme per sa kohe asnjera nga palet nuk ka njoftuar me shkrim ndryshimin e ketyre adresave:


Per Kolateralmarresin: Banka e Pare e Investimeve – Albania, ShA.
Adresa: “Kullat Binjake” kati 14-15, Bulevardi “Deshmoret e Kombit” Tirane,Shqiperi.

Per Kolateraldhenesin: Fier, Lagja Sheq i Madh, Rruga nacionale Fier - Tiranë, Pranë Urës së Mbrostarit.
Per Kolateraldhenesin: Fier, Lagja Sheq i Madh, Rruga nacionale Fier - Tirane, Prane Ures se Mbrostarit, Fier
Per Pranuesin e Kolateralit: Fier, Rr. Blv. Jakov Xoxa, Lagjia Kongresi i Permetit.

Para meje noter, në datën e sipërpërmendur Palët nënshkruan Kontratën ose autorizuan përfaqësuesit e tyre për nënshkrimin e saj dhe une vertetoj nënshkrimet e tyre sipas ligjet.

PËR KOLATERALMARRËSIN
Banka e Pare e Investimeve – Albania ShA


Elma Lloja
Drejtoare Ekzekutive


Ina Paskaleva
Drejtoare e Departamentit te Menaxhimit te Riskut



PËR KOLATERALDHËNËSIN
SA-GLE KOMPANI SHPK


Adm. Anilda Besim Goga

AG Hpower & Construction SHPK


Adm. Zeni Nebi Tërpollari

PRANUES I KOLATERALIT


Arben Pandi Goga

Perktheu:






EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	K92227019N	
2. Data e Regjistrimit	27/10/2009	
3. Emri i Subjektit	SA-GLE KOMPANI	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	10/10/2009	
6. Kohëzgjatja	Nga: 10/10/2009/10/10/2044	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Fier Fier FIER Lagja Sheq i Madh, Rruga nacionale Fier-Tiranë, Pranë Urës së Mbrostarit.	
8. Kapitali	100.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	100,00	
9. Objekti i aktivitetit	Ndertimi, operimi, financimi, venia në punë, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi, shitja e energjisë elektrike dhe transferim i hidrocentraleve në zbatim të kontratës së koncesionit datë 14.09.2009 "Për ndertimin e hidrocentraleve në rrjedhën e perroit Trebisht-Rrethi Bulqize të nënshkruar ndërmjet "Autoritetit Kontraktor" dhe "Koncesionarit"	
10. Administratori/ët	Anilda Goga	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 01/03/2022	Deri: 01/03/2027
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	AG Hpower & Construction	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 100.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	100,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Diber TREBISHT TREBISHT Fshati Trebisht, Komuna Trebisht, Rrethi Bulqize	
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: SA-GLE KOMPANI E-Mail: aghpowershpk@gmail.com Telefon: 0696049707	

15. Statusi:	Aktiv

Datë: 14/09/2022

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L91924026B
2. Data e Regjistrimit	24/07/2019
3. Emri i Subjektit	AG Hpower & Construction
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	23/07/2019
6. Kohëzgjatja	Nga: 23/07/2019
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Fier Fier FIER Lagja Sheq i Madh, Rruga nacionale Fier - Tirane, Prane Ures se Mbrostarit, Fier.
8. Kapitali	100.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00
9. Objekti i aktivitetit	Studim projektim e ndertim i ndertesave civile e industriale, rrugeve, tuneleve, urave mbi dhe nen kalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, digave dhe veprave hidroteknike bonifikuese ose vaditese, uiesiellsave, kanalizimeve te uirave te bardha e te zeza, linjave mbi dhe nentokesore te energjiise dhe telekomunikacionit, centraleve dhe hidrocentraleve, rrjeteve inxhinjrike, porteve dhe aeroporteve. Prodhim dhe Tregtim te Energiise Elektrike. Prodhimin dhe tregtimin e materialeve te ndertimit, betonit dhe asfaltit, importin dhe eksportin. Kerkimin, nxirrjen, perpunimin, tregtimin dhe import eksportin dhe cdo veprimtari qe lidhet me burimet dhe resurset natyrore.Me qellim kryerjen e aktiviteteve te mesiperme, shoqeria mund te ushtroje veprimtarine e saj ne Shqiperi dhe jashte saj e te kryeje çdo aktivitet tjetër te lidhur, ndihmes, te ngjashem, plotesues apo te dobishem per permbushjen e objektit te saj. Per permbushjen e objektit te saj, Shoqeria mund te: Te zoteroje direkt ose indirekt pjesemarrje ne shoqeri dhe/ose sipermarrje te tjera, shqiptare apo te huaja, qe kryejne aktivite te njejta, te ngjashme apo te lidhura me aktivitetin e saj ose qe mund te ndihmojne ne realizimin e objektit te Shoqerise; Te kryeje çdo aktivitet e transaksion tregtar, ne lidhje me pasuri te luajtshme e te paluajtshme: Te jape dorezani, hipoteka, garanci reale dhe/ose personale; Te themeloje dege, zyra perfaqesimi dhe ne pergjithesi te kryeje çdo aktivitet tjetër qe nuk eshte i

	ndaluar nga ligji. Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaike, eolike, hidrike) te energjise elektrike, te cilat shfrytezojne burimet e rinovueshme te energjise si dielli, era, uji, si dhe i veprave te tyre ndihmese. Aplikimi dhe marrja nga qeveria shqiptare apo institucionet pergjegjese te shtetit shqiptar i te gjitha lejeve, licencave dhe autorizimeve paraprake/perfundimtare, te cilat mundesojne zhvillimin e ketyre aktiviteteve ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi ne Republiken e Shqiperise. Shitja me shumice dhe pakice e energjise elektrike tek operatoret, furnizuesit, tregtaret, konsumatoret e energjise elektrike (vendas apo te huaj), si dhe ne Bursen Shqiptare te Energjise Elektrike (ALPEX), apo Bursat e tjera te energjise jashte vendit.	
10. Administratori/ët	Zeni Tërpollari	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 23/07/2019	Deri: 23/07/2024
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	ArbenGoga	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 100.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: AG Hpower & Construction E-Mail: aghpowershpk@gmail.com Telefon: +355 69 60 49 707	
15. Statusi:	Aktiv	

Datë: 14/09/2022

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)